

**UDHËZIM**  
**Nr. 5, datë 4.5.2018**

**PËR PËRJASHTIMI NGA ZBATIMI I SISTEMIT TË VETËKONTROLLIT PËR  
OPERATORË TË VEÇANTË TË BIZNESIT USHQIMOR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, si dhe në zbatim të nenit 26, pika 7, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", i ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

1. Kërkesë për përjashtim nga zbatimi i sistemit të vetëkontrollit mund të bëjnë operatorë të vegjël ushqimor që tregtojnë sasi të vogla produktesh ushqimore, kategori të veçanta operatorësh, si dhe prodhues të produkteve tradicionale.

2. Operatorë të vegjël ushqimor janë individë ose bashkim individësh të cilët shesin direkt për konsumatorin produktet e prodhuara prej tyre në sasi të vogla produktet primare dhe/ose të përpunuara me origjinë shtazore dhe joshtazore.

3. Shitje në sasi të vogla të konsiderohen:

- qumësht dhe produkte me bazë qumështi të shitur nga ferma që kanë jo më shumë se 3 (tre) krerë lopë;

- qumësht dhe produkte me bazë qumështi të shitur nga ferma që kanë jo më shumë se 30 krerë të imta;

- pula të gjalla dhe vezë të shitura nga ferma me jo më shumë se 50 krerë pula;

- mjaltë nga ferma me jo më shumë se 30 koshere;

- pastërma e përftuar nga ferma që kanë jo më shumë se 3 (tre) krerë lopë dhe/ose jo më shumë se 30 krerë të imta;

- fruta dhe perime të freskëta, si dhe produkte të përpunimit të tyre nga ferma familjare;

- produkte ushqimore të prodhuara në mënyrë artizanale sipas traditës së zonës.

4. Operatorët e biznesit ushqimor të përcaktuar në pikën 1 i shesin produktet e tyre brenda territorit të njësisë administrative në të cilën ushtrojnë aktivitetin. Ato mund të tregtohen direkt te konsumatori i fundit, në portën e fermës së tij, në tregun lokal, në rrjetin e dyqaneve "EDUA", restorantet, bujtinat e hotelet brenda territorit të njësisë administrative. Produktet primare shiten direkt në evente të tilla, si: tregje ditore, panaire, festa fetare etj.

5. Operatorët sipas pikës 11 të këtij udhëzimi mbajnë të dhëna për gjurmueshmërinë e ushqimit nga prodhuesi te konsumatori.

6. Operatorët e biznesit ushqimor të cituar në pikën 1, të cilët duan të listohen sipas pikës 11, paraqesin një kërkesë me shkrim pranë MBZHR-së. Kërkesa duhet të përmbajë:

a) Emër, mbiemër;

b) Adresa;

c) Llojin dhe sasinë e produkteve të prodhuara;

d) Llojin dhe sasinë e produkteve që kërkon të shesë;

e) Vendin e shitjes së produkteve

7. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune, MBZHR-ja shqyrton kërkesën dhe ja përcjellë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) për të verifikuar nëse operatori garanton një nivel të pranueshëm higjienik në zbatim të sistemit të procedurave të vetëkontrollit, sipas praktikave të mira të kontrollit.

8. AKU-ja, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga marrja e kërkesës, kryen verifikimin për kushtet higjienike dhe dërgon në Ministri raportin mbi verifikimin e kryer.

9. Ministria shqyrton raportin e ardhur nga AKU-ja dhe sipas rastit liston ose jo aplikuesin në listën e bizneseve të përjashtuara nga zbatimi i sistemit të vetkontrollit. Në të dyja rastet, Ministria njofton aplikuesin.

10. Ministria shqyrton të gjitha rastet e ankesave nga aplikuesit.

11. Operatorët e biznesit ushqimor që plotësojnë kërkesat e këtij udhëzimi përjashtohen nga zbatimi i sistemit të vetëkontrollit dhe listohen në listën, modeli i së cilës jepet në Shtojcën I bashkëlidhur këtij udhëzimi. Përditësimi i listës së operatorëve të biznesit ushqimor të përjashtuar nga sistemi i vetëkontrollit bëhet rast pas rasti.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË DHE  
ZHVILLIMIT RURAL  
**Niko Peleshi**

SHTOJCË I

<b>Nr.</b>	<b>Emër mbiemër</b>	<b>Lloji i aktivitetit</b>	<b>Adresa</b>	<b>Sasia e produktit të shitur për lloj produkti</b>	<b>Vendi i shitjes së produktit</b>